



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/33

Datë: 30.08.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 8 dhe nenin 15 paragrafin 4. të Ligjit Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, të nenit 89 dhe 90 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, duke u bazuar në nenin 4. të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020, për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011, me qëllim të menaxhimit më të mirë dhe fuqizimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti për koordinimin dhe vlerësimin e situatës me pandeminë COVID-19, në këtë përbërje:
 - 1.1. Dr. Arben Vitia, Kryesues;
 - 1.2. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Zëvendëskryesues;
 - 1.3. Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës, anëtar;
 - 1.4. Mehdi Sejdiu, Këshilltar i Zëvendëskryeministrit të parë të Republikës së Kosovës, anëtar;
 - 1.5. Prof. Dr. Naser Ramadani, anëtar;
 - 1.6. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), anëtar;
 - 1.7. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), anëtar;
 - 1.8. Ministria e Drejtësisë (MD), anëtar;
 - 1.9. Ministria e Mbrojtjes (MM), anëtar;
 - 1.10. Ministria e Shëndetësisë (MSh), anëtar;
 - 1.11. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), anëtar;
 - 1.12. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), anëtar;
 - 1.13. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), anëtar;
 - 1.14. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), anëtar;
 - 1.15. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), anëtar;
 - 1.16. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), anëtar;
 - 1.17. Ministria e Ekonomisë (ME), anëtar;
 - 1.18. Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), anëtar;
 - 1.19. Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), anëtar;
 - 1.20. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, anëtar;
 - 1.21. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, anëtar;
 - 1.22. Policia e Kosovës, anëtar;
 - 1.23. Këshilli për Siguri, anëtar;
 - 1.24. Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, anëtar;
 - 1.25. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), anëtar;

- 1.26. Inspektorati i Tregut\ (MINT), anëtar;
1.27. Ftohet ta dërgoj një përfaqësues, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, anëtar.
2. Sekretariatit e Komitetit do ta caktojë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë.
 3. Komiteti obligon Komunitet që të themelojnë nën komitete komunale me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë.
 4. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që në bashkëpunim të ngushtë me njësitë tjera përkatëse të ndërmarrin veprimet e nevojshme për menaxhimin dhe kontrollin e pandemisë COVID-19.
 5. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë Nr. 01/07 i datës 22.06.2020.
 6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë